

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Prapaskenat e mbledhjes të Këshillit të Sigurisë/ Çfarë tha Edi Rama për Vlora Hysenin dhe skandalin në SHISH, kreu i SPAK zbardh si arritën të masa e sigurisë
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/prapaskenat-e-mbledhjes-te-keshillit-te-sigurise-fare-tha-edi-rama-pe-i402208
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 18:05:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 17:54:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2274b89a1c927d15a70e95fd6999abf83eb2643d5d3af603d03bfdb8b3d93cf6
TEKSTI	4eb9226f2b1433790c010985afe09ea7cc5af28ec1b363c30772e3a371ad60d1
PAMJA	cd26d8ba2daab12d4728c876516cc827566ad7aa17b278503ebfdded2882faa0d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e6940999ab1f020233800c7f8fb7ac6dd9ea1e532e2e047b4b45fbdd046a8ec3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	e5625a2b3a70b3c40eaff938d2f4a87fb4cf81b6cc2ef2b38db74408074a14f5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e6940999ab1f020233800c7f8fb7ac6dd9ea1e532e2e047b4b45fbdd046a8ec3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

28 Shtator 2026, 19:54

Prapaskenat e mbledhjes të Këshillit të Sigurisë/ Çfarë tha Edi Rama për Vlora Hysenin dhe skandalin në SHISH, kreu i SPAK zbardh si arritën te masa e sigurisë

Shkruar nga Newsbomb



Pamje nga mbledhja

Që në orët e para të mëngjesit të kësaj të hëne, u mbledh Këshilli i Sigurisë Kombëtare në një mbledhje të jashtëzakonshme, të thirrur në një moment të ndjeshëm për institucionet e sigurisë, pas masës së arrestit ndaj ish-drejtoreshës së Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlora Hyseni. Në fokus të kësaj mbledhje ishte edhe impakti që kjo çështje mund të ketë në funksionimin dhe bashkëpunimin mes institucioneve të sigurisë.

Sipas burimeve të Top Channel një nga çështjet e ngritura gjatë diskutimeve lidhet me verifikimet e kryera brenda Shërbimit Informativ Shtetëror pas masës së sigurisë ndaj ish-drejtoreshës së institucionit.

Kreu i komanduar i SHISH, Elvis Lila, mësohet të ketë këmbëngulur se pas një auditimi tepër sekret të kryer në institucion, nuk ka rezultuar që nga Shërbimi Informativ Shtetëror të jenë nxjerrë dokumente apo materiale që cenojnë sigurinë kombëtare të vendit.

Sipas të njëjtave burime, në diskutim është vënë theksi edhe te detyrimi ligjor i institucioneve të sigurisë për të mbledhur, administruar dhe ruajtur informacionin e klasifikuar, por njëkohësisht edhe te nevoja për bashkëpunim të vazhdueshëm mes strukturave shtetërore që kanë nënroditje në këtë fushë.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit



Bota

Starship arrin në orbitë, por anija kozmike e Space X shpërtheu gjatë uljes në Oqeanin Paqësor (VIDEO)



Politikë

Spiropali takon reporterin evropian: Kafë informale apo një "mesazh i koduar" për Ramën?

Zbulu më shumë artikuj

Në mbledhje ka folur edhe kreu i Prokurorisë së Posaçme, Klodian Braho, i cili u ka shpjeguar drejtuesve të institucioneve të pranishme arsyet që kanë çuar SPAK-un drejt kërkesës për caktimin e një mase sigurie ndaj ish-drejtoreshës së SHISH.

Braho mësohet të ketë bërë të ditur se vendimarrja e prokurorëve është mbështetur në administrimin e provave sekrete në kuadër të hetimit, ndërsa në dosjen hetimore janë përfshirë edhe të dhëna të siguruara gjatë veprimeve hetimore, mes tyre edhe kontrolle të kryera në banesa.

Sipas shpjegimit të dhënë nga kreu i SPAK, pasi grupi i hetimit ka administruar dhe vlerësuar provat e mbledhura, është arritur në përfundimin se ekzistonin kushtet për t'iu drejtuar gjykatës me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, vendim i marrë në kuadër të hetimit penal.

Në mbledhje është diskutuar gjithashtu edhe përgjegjësia institucionale dhe mënyra se si duhet të menaxhohet situata në mënyrë që një çështje individuale të mos kthehet në një problem më të gjerë për funksionimin dhe besimin të institucionet e sigurisë.

Ndërkohë sipas të njëjtave burime mësohet se kryeministri Edi Rama ka theksuar se përgjegjësia është individuale, ndërsa ka kërkuar që të gjenden mekanizma të reja për ndërveprimin dhe koordinimin mes institucioneve, me qëllim mbrojtjen e interesit dhe sigurisë kombëtare.

Në të njëjtën linjë, presidenti Bajram Begaj i cili thirrri mbledhjen e jashtëzakonshme, ka përcaktuar detyra për institucionet dhe ka vënë theksin te ruajtja e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë, duke bërë të qartë se nuk duhet të ketë ndërhyrje në punën e Prokurorisë së Posaçme.

Më herët, Begaj bëri të ditur se qëllimi i mbledhjes ishte diskutimi i situatës së krijuar dhe masave që institucionet duhet të ndërmarrin për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, bashkëpunimit me partnerët dhe aleatët, si dhe ruajtjen e besimit të publikut të institucionet e sigurisë.

Në përfundim të mbledhjes, mesazhi i përcjellë ishte se institucionet që kanë përgjegjësi në fushën e sigurisë kombëtare nuk duhet të konkurrojnë me njëri-tjetrin, por të bashkëpunojnë dhe të koordinohen në funksion të të njëjtit interes shtetëror.

Presidenti Begaj ka theksuar gjithashtu se hetimet e drejtësisë duhet të zhvillohen në mënyrë tërësisht të pavarur dhe të respektohen nga të gjitha institucionet, ndërsa çështjet individuale nuk duhet të shndërrohen në një krizë besimi ndaj shtetit apo strukturave të sigurisë.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



Përfshihet nga flakët automjeti në qendër të Elbasanit, qytetarët largohen me vrap nga vendngjarja



Aktualitet

Flakët "përpijnë" Kreshpanin e Fierit, shkrumbohen dhjetëra rrënjë ullinj! Kërkohej ndërhyrje nga ajri

E Hënë 18:19



Aktualitet

Këshilli Bashkiak i Belshit kundër bashkimit me Elbasanin: PS abstenon, PD voton kundër

E Hënë 18:17



E Hënë 17:36

Zjarri përfshin masivin pyjor në Mat, flakët favorizohen nga era dhe afrohen pranë banesave



Aktualitet

Zjarri i madh "pushton" kodrën në Mëmlisht në Pogradec, flakët kërcënojnë masivin me pisha

E Hënë 16:58



Aktualitet

Rama mbledhi drejtuesit politikë të PS-së në qarqe, në fokus ishte "Prania Besnike" dhe shqetësimet e qytetarëve

E Hënë 16:43





E Hënë 16:21

Përfshihet nga flakët automjeti në lëvizje në aksin Ura e Çerenecit-Librazhd, shpëtojnë mrekullisht dy persona



KAVAJE



Aktualitet

Blutë e Kavajës zbardhin 6 grabitjet në qytet, arrestohen "skifterët" duke qarkulluar me automjet të vjedhur

E Hënë 15:53

Aktualitet

Gazetari nga Kosova shkruan për DY RUSËT që urdhëruan Vlora Hysenin të vëzhgonte diplomatin amerikan, hakerat u publikojnë IDENTITETET

E Hënë 15:36



Aktualitet

E Hënë 15:28

Alarm në Lezhë! Flakët përfshijnë bimësinë, rrezikohen banesat nga përhapja e zjarrit



Aktualitet

Përdhunoi një shtetase dhe më pas i vodhi paratë, shpallet në kërkim 43-vjeçari në Vlorë

E Hënë 15:03




Aktualitet

Të gjithë duan paga më të larta! Garda e Republikës kërkon vëmendje: Jemi 24/7 në misione me rëndësi të veçantë shtetërore, por paguhemi më pak (E PLOTË)

E Hënë 14:59

Aktualitet

TIRANË



FILE-18.49

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.